

L I G J
Nr.7983, datë 27.7.1995

PËR SHITBLERJEN E TOKËS BUJQËSORE, LIVADHEVE DHE KULLOTAVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim rregullimin juridik të kalimit të pronësisë mbi tokën bujqësore, livadhet dhe kullotat, nëpërmjet shitjes dhe blerjes.

Toka bujqësore, livadhet e kullotat pronë shtetërore, nuk mund të shiten deri në kompensimin e ish-pronarëve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj.

Shitblerja e tokës bujqësore, livadheve e kullotave, bëhet me anën e kontratës së shitblerjes, siç është parashikuar në Kodin Civil.

Neni 2

Për efekt të këtij ligji do të përdoren përkufizimet e mëposhtme:

- | | |
|-------------------------------|--|
| "Tjetërsim" | - Kalim i së drejtës së pronësisë së tokës bujqësore, liva-dheve e kullotave nëpërmjet shitblerjes. |
| "Tokë bujqësore e familjes" | - Toka bujqësore që i është dhënë në pronësi familjes sipas dispozitave të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën". |
| "Livadh e kullotë e familjes" | - Janë ato sipërfaqe që familja ka fituar në pronësi sipas ligjit nr.7917, datë 13.4.1995 "Për livadhet dhe kullotat". |

Neni 3

Çdo kalim pronësie i tokës bujqësore, livadheve e kullotave që është përfituar sipas ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën" dhe ligjit nr.7917, datë 13.4.1995 "Për livadhet dhe kullotat", por që nuk është regjistruar sipas ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", është i pavlefshëm.

Neni 4

Kur familja dëshiron ta tjetërsojë pronësinë mbi tokën bujqësore, livadhet e kullotat, i paraqet regjistruesit dokumentet e shënuara më poshtë:

a) Një kërkesë për regjistrimin e aktit noterial të shitblerjes së tokës bujqësore, livadheve e kullotave të familjes, e cila duhet të jetë e firmosur nga kryetari i familjes, emri i të cilit është regjistruar si pronar i kësaj toke në kartelën përkatëse të regjistrit të pasurisë së paluajtshme.

b) Një prokurë të posaçme të noterizuar, në të cilën pjesëtarët e familjes bujqësore që në momentin e tjetërsimit gëzojnë zotësi për të vepruar dhe që kanë qënë anëtarë të familjes në momentin e marrjes në pronësi të kësaj toke, prej kësaj të fundit, vërtetojnë se kryetarin e familjes e caktojnë përfaqësues ligjor për efekt të tjetërsimit të tokës bujqësore, livadheve e kullotave të familjes nëpërmjet shitjes.

Shitja e mundshme e tokës bujqësore livadheve e kullotave duhet të lajmërohet në mënyrë të tillë që anëtarët e familjes, të cilët nuk banojnë me kryetarin, të kenë mundësi të shprehin mendimin e tyre në lidhje me tjetërsimin. Nëse anëtari i sipërtreguar nuk përgjigjet brenda 15 ditësh nga dita kur i është bërë lajmërimi, ai/ajo do të trajtohet sikur ka dijeni për blerjen.

Neni 5

Në rastet kur njëri prej anëtarëve të familjes bujqësore dëshiron të shesë pjesën, ose një pjesë të tokës bujqësore livadheve ose kullotave që i përket, veprohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil për bashkëpronësinë.

Neni 6

Kur familja, personi, dëshiron të shesë tokën bujqësore, livadhin ose kullotën, detyrohet të bëjë publikimin e ofertës në fshat, duke respektuar radhën e përparësisë së të tretëve, me përjashtim të rasteve të nenit 5 të këtij ligji si më poshtë:

1. Të paralindurve dhe të paslindurve madhorë në vijë të drejtë, vëllezërve dhe motrave.
2. Kufizuesve të parcelës - objekt shitblerjeje.
3. Ish-pronarit.
4. Banorëve të tjerë të fshatit.
5. Cilitdo shtetasi shqiptar.

Brenda së njëjtës shkallë përparësie i jepet prioritet afërsisë gjeografike të parcelës që shitet me parcelat e kandidatëve të vlerës.

Neni 7

Ofertës së bërë nga shitësi i duhet përgjigjur brenda 15 ditëve. Mospërgjigjia tej këtij afati konsiderohet si refuzim i ofertës.

Për çdo ndryshim oferte përsëritet procedura e parë.

Neni 8

Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme nuk bën regjistrimin kur:

- a) nuk është zbatuar rradha e parablerjes që përcaktohet nga ky ligj;
- b) madhësia e parcelës që shitet ose e asaj që mbetet pas shitjes, është më e vogël se njësia minimale e kultivimit;
- c) nga blerja mund të përfitojnë personat që nuk e gëzojnë këtë të drejtë;
- d) kur vëren shkeljen e ndonjëres nga kërkesat e këtij ligji.

Neni 9

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 10

Paragrafi i dytë i nenit 2 të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” , si dhe çdo akt nënligjor që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1176, datë 4.8.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha